



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



**Lista Përfundimtare e Votuesve të
Kosovës
2009**

Qëllimi

Ky dokument ofron sqarime të përgjithshme në lidhje me përpilimin e Listës së Votuesve 2009 e cila i është dorëzuar KQZ-së për aprovim. Ekipi për Shërbim të Votuesve ka kryer aktivitetet e tyre në përputhje me ligjin zgjedhor dhe me procedurat e rregullores së punës së KQZ-së.

Ky dokument vërteton procesin e ndërmarrë dhe jep shembuj se si do të prodhohet lista e votuesve brenda Kosovës.

KQZ-ja është e obliguar që të *certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet* në bazë të nenit 64.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (ligji numër 03/L-073). Ky dokument e mbështet procesin e certifikimit të listës së votuesve.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve 2009 (**LPV 2009**) për Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetarë të Komunave 2009 bazohet në ekstraktin e regjistrit civil (kapitulli 2 neni 7.1 a) i ligjit 03/L-073). Ky ekstrakt është përpiluar nga Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

LPV-ja 2009 përmban 1,563,741 emra të votuesve të ndarë në 36 Komuna, 746 Qendra të Votimit dhe 2256 Vendvotime.

Si shtesë, LPV 2009 përmban emrat e të gjithë votuesve me zotësi juridike të cilët kanë aplikuar me sukses në programin e votimit jashtë Kosovës (kapitulli 2 neni 7.1 b) të ligjit 03/L-073)

Përshkrim

Pas pranimit të ekstraktit të regjistrit civil dhe para se ekipi i Shërbimit të Votuesve të caktoj votuesit për lokacion të votimit, është dashur të merren parasysh disa faktorë të ri sipas rrethanave të krijuara. Së pari, procesi i decentralizimit¹ ka krijuar 6 komuna² të reja. Më pas, ky proces ka rezultuar në ri-caktimin e kufijve ekzistues. Së dyti, ligji ri mbi zgjedhjet kërkon që votuesve duhet, kur kjo është e mundur, t'ju caktohet vendvotimi brenda 3 km nga vendbanimi i tyre³. Në fund, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë një sqarim të dytë nga Ministria e Pushtetit Lokal i cili thotë se fshati Kishnicë i takon komunës së Graçanicës^{4 5}

¹ Ligji mbi Kufijtë Administrativ (Ligji 03/L-041)

² Vendimi i grupit ndërmintor për decentralizim më 15 shtator 2009 – duke përfshirë Mitrovicën e Veriut dhe Parteshin

³ Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme 03/L-073 (kapitulli 13 neni 83.3)

⁴ Më 29 shtator, KQZ-ja kërkoi sqarim nga MPL-ja se cilës komunë i takon fshati Kishnicë. Fillimisht, përgjigja e dërguar nga MPL-ja më 29 shtator, sqaron se ky fshat i takon komunës së Prishtinës. Ky vendim u ndryshua me një letër tjetër që u lëshua nga MPL-ja më 12 Tetor e cila sqaronte se tani fshati Kishnicë i takon komunës së Graçanicës. Një letër është dërguar nga Z. Peter Feith-ICR më 13 Tetor

Prandaj, baza e përpilimit të listës së votuesve 2009 ka filluar me krijimin e listës së qendrave të votimit e cila përputhet me aranzhimin e krijimit të komunave të reja. Kjo listë e Qendrave të Votimit është bazuar në rekomandimet e bëra nga ana e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) të përcjella me konsultime lokale. 125 qendra të reja janë rekomanduar të hapen. Këto qendra të reja janë vlerësuar sipas lokacionit, kapacitetit dhe ndërtesave në dispozicion. Sipas shqyrtimit, më pas njësitë gjeografike / kodet i janë caktuar secilës qendër të re të votimit.

Me vendimin e KQZ-së i cili konfirmon numrin e ri të Qendrave të Votimit, hapi tjetër ka qenë caktimi i votuesve të rinj dhe atyre të prekur nga decentralizimi. Kjo listë e votuesve i është dërguar KKZ-ve për rishikim dhe konfirmim të caktimit të qendrave votuese. Pas këtij rishikimi, gjithsej 264,988 karta postare i janë dërguar votuesve të rinj dhe atyre të cilëve i është ri-caktuar qendra, për të konfirmuar se në cilin lokacion të votimit janë përcaktuar.

Pas një caktimi fillestar të votuesve, kanë pasuar dy periudha të rishikimeve: periudha e shërbimit të votuesve në të cilën votuesit kanë qenë të informuar në lidhje me lokacionin e ri, kanë pas mundësi që të ndërrojnë Qendrën dhe t'i përmirësojnë/ndryshojnë të dhënat e tyre – si dhe periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit në të cilën votuesit kanë mundur të sfidojnë përfshirjen apo mos-përfshirjen e ndonjë votuesi në listën e votuesve.

Periudha e shërbimit të votuesve

Të gjithë votuesit kanë pas mundësi që të kontaktojnë zyrën për shërbimin e votuesve gjatë periudhës së shërbimit votuesve (nga 01/09/09 deri më 15/09/2009) për t'u informuar se në cilën qendër votuese janë ri-caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit i cili është më i përshtatshëm për ata. Gjatë kësaj periudhe 4538 votues kanë vizituar zyrat e KKZ-ve, 1550 votues kanë kërkuar **ndërrim të qendrës së votimit**. Prej këtyre kërkesave, 91 janë refuzuar; 60 votues janë refuzuar për arsye se Qendra Votuese në të cilën ata kanë kërkuar të votojnë nuk ka qenë përbrenda kufijve të komunës ku ata jetojnë; 5 votues janë refuzuar për arsye se nuk kanë sjellë asnjë dokument identifikimi me vete dhe 26 votues kanë aplikuar më shumë se një herë për ndërrime dhe janë konsideruar si aplikues të dyfishtë. Për më tepër, qasja e konfirmimit të lokacionit në formë elektronike ende është e publikuar.

Pas kësaj periudhe, zyra për shërbim të votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve e cila më pas është integruar në ekstraktin e pranuar nga DPD-ja. Bazuar në këto të dhëna, zyra për shërbimin e votuesve ka krijuar listën e përkohshme të votuesve (LPV). LPV-ja ka qenë prezantimi i parë publik i listës së votuesve e cila do të përdoret për këto zgjedhje. LPV ka qenë e ndarë në dokumente (formati PDF) për secilën Qendër Votuese. Këto dokumente i janë dërguar KKZ-ve dhe kanë qenë të postuara në faqen e internetit të Sekretariatit të KQZ-së. Gjithashtu, CD me kopje të LPV-së kanë qenë të përgatitura dhe i janë shpërndarë subjekteve politike dhe vëzhguesve.

dhe është pranuar më 19 Tetor nga KQZ-ja në të cilën Z.Feith shprehte përkrahjen e tij për letrën e dytë të lëshuar nga MPL-ja.

⁵ KQZ-ja do të caktoj votuesit e Kishnicës në komunën e Gracanicës – megjithatë, shpërndarja e votuesve sipas zonave kadastrave rezulton si në vijim: 209 votues në komunën e Gracanicës; 249 votues në komunën e Prishtinës; dhe një votues në komunën e Lipjanit.

Periudha e kundërshtimit dhe Konfirmimit

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit (nga 22/09/09 deri më 02/10/2009) i ka mundësuar të gjithë votuesve në Kosovë si dhe atyre të regjistruar me operacionin përmes postës që të sfidojnë LPV-në. Gjatë kësaj periudhe, 345 votues kanë konfirmuar të dhënat e tyre dhe 21 kanë sfiduar LPV-në. Pas periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, zyra e Shërbimit të Votuesve ka marrë 16 vendime të gjykatave Komunale, 5 prej këtyre kanë qenë kërkesa për largimin e personave të vdekur dhe që figurojnë në LPV, 8 kanë qenë vendime për ri-caktim të Qendrave të Votimit dhe 3 vendime nuk janë aplikuar pasi që votuesit tashmë nuk ishin të përfshirë në listën e votuesve.

Krijimi i LPV-së

Pas gjithë këtyre fazave, Zyra për Shërbim të Votuesve i ka klasifikuar votuesit nëpër Qendra të Votimit sipas alfabetit. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e zyrës për Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëj shtypjen përfundimtare të LPV-së 2009.

Rekomandimet për Regjistrin Civil

Ekipi për Shërbim të Votuesve i falënderohet Ministrisë së Punëve të Brendshme për bashkëpunim dhe mbështetje si dhe jep rekomandimet në vijim për krijimin e LPV-ve në të ardhmen:

- 1 Mënyra efektive për mënjanimin e emrave të personave të vdekur
- 2 Rritja e saktësisë së informatave lidhur me adresat e votuesve
- 3 Rishikimi i kodeve gjeografike i të regjistruarve
- 4 Të sigurohet që të regjistruarit të kenë qasje në Zyrat e Regjistrimit Civil në tërë Kosovën.

Votimi përmes Postës

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes 07 Gushtit dhe 06 Shtatorit; periudhë kjo e zgjatur deri më 15 Shtator. Përafërsisht, 10000 aplikacione i janë dërguar kandidatëve për votim përmes postës në bazë të dhënave të vitit 2007. 24.400 forma tjera për aplikim i janë dërguar pikave të shpërndarjes në vendet tjera. Deri në skadim të afatit gjithsej 2630 aplikacione kanë qenë të pranuar, prej të cilave 1,806 janë aprovuar dhe 824 janë refuzuar kryesisht për shkak të dhënave jo të plota. Vendimi i KQZ-së i marrë më 29 Shtator, ka aprovuar refuzimin e dy aplikacioneve pasi që individët në fjalë tani jetojnë në Kosovë dhe emrat e tyre gjinden në listën e votuesve në Kosovë. Janë pranuar aplikacione nga 26 vende. KQZ-së, në mbledhjen e saj të 42-të më 15 tetor i është dhënë një prezantim i shkurtër i procesit të Votimit me Postë dhe i është shpërndarë një raport i shkurtër në të njëjtën kohë.

Përmbledhje në lidhje me votuesit

- 1.1 Numri i Përgjithshëm i Votuesve në LPV 2009 **1 563 741**. Bazuar në të dhënat nga DPD-ja, Zyra për Shërbim të Votuesve ka larguar **22851** votues të vdekur

nga LPV-ja , **3000** të cilët nuk kanë marrë kurrfarë dokumenti të regjistrimit (nga UNMIK-u apo Kosova) si dhe ka larguar 7 votues të regjistruar dy herë.

1.2. Numri përgjithshëm i Votuesve, Qendrat e Votimit si dhe vendvotimet për Komunë

Komuna	Numri i votuesve	Numri i Qendrave të Votimit	Numri i Vendvotimeve
1 - Deçan/Deçani	35727	8	49
2 - Gjakovë/Đakovica	91866	28	129
3 - Gllgovc/Glogovac	44713	20	59
4 - Gjilan/Gnjilane	87430	31	127
5 - Dragash/Dragaš	35454	28	53
6 - Istog/Istok	38533	15	55
7 - Kaçanik/Kaçanik	29397	16	42
8 - Klinë/Klina	36576	16	51
9 - Fushë Kosovë/Kosovo Polje	26154	9	37
10 - Kamenicë/Kamenica	34540	25	51
11 - Mitrovicë/Mitrovica	83307	32	123
12 - Leposavić/Leposaviq	16550	17	30
13 - Lipjan/Lipljan	48084	26	71
14 - Novobërdë/Novo Brdo	7938	18	19
15 - Obiliq/Obilić	20204	14	31
16 - Rahovec/Orahovac	47400	34	71
17 - Pejë/Peć	89156	23	121
18 - Podujevë/Podujevo	72968	43	104
19 - Prishtinë/Priština	154935	56	216
20 - Prizren/Prizren	137849	60	198
21 - Skenderaj/Srbica	47598	32	70
22 - Shtime/Štimlje	21530	10	32
23 - Štrpce/Shtërpçë	12260	9	18
24 - Suharekë/Suva Reka	55532	30	79
25 - Ferizaj/Uroševac	88306	25	122
26 - Viti/Vitina	41438	26	58
27 - Vushtri/Vučitrn	60762	24	87
28 - Zubin Potok/Zubin Potok	7482	12	15
29 - Zvečan/Zvečan	8409	6	13
30 - Malishevë/Mališevo	42318	29	65
31 - Juniku/Junik	4962	1	7
32 - Mamusha/Mamuša	2835	1	4
33 - Hani i Elezit/Đeneral Janković	7683	4	12
34 - Gračanica/Gračanica	16317	10	25
35 - Ranilug/Ranillugu	4822	3	7
37 - Klokot/Kllokoti	2706	5	5
GJITHSEJ:	1 563 741	746	2256